

PKR.nr.421/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga trupi gjykues prej tre gjyqtarët profesionistë, përkatësisht gjyqtari Naser Foniqi – kryetar i trupit gjykues dhe Vehbi Kashtanjeva e Isuf Makolli, anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësin **Arianit Mahmutaj**, në çështjen penale të akuzuarve: B.Q, i akuzuar për shkak të veprave penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375, par. 2, të KPRK dhe Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par. 1, të KPRK dhe F.H, i akuzuar për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par.1, të KPRK, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr. 690/2013, të datës 29.07.2015, pas shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 30.04.2018, në të cilin ishin të pranishëm: Prokurori i shtetit Ilaz Beqiri, i pandehuri B.Q, të dëmtuarit-dëshmitarët: Florim dhe V.H , ndërsa ka munguar e dëmtuara S.H, pas shqyrtimit gjyqësor, të njëjtën ditë, me datë 30.04.2018, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarve:

B.Q, i biri i Fatmir dhe Igballe, e vajzërisë Krasniqi, i lindur me..., në P, Lagja D., rr."Z.S" nr., me numër personal..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i punësuar- realizon pagë mujore në shumë prej ... euro, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak nga data 31.07.2013 deri me datë 31.08.2013 dhe

F.H, i biri i A dhe J, e vajzërisë G., i lindur me..., në P, rr.M.K, nr., me numër personal..., ka të kryer 4 klasë të shkollës fillore, i martuar-baba i 7 fëmijëve, i pa punë - realizon ndihmë sociale në shumë prej ..euro në muaj, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363, par. 1, nënpar. 1.1, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës,

REFUZOHET AKUZA

- S e p s e:** i akuzuari B.Q, me datë 31.07.2013, rreth orës 13:50, në Prishtinë, në parkun e qytetit, nën kërcënim ka përdorur armën, në atë mënyrë që gjatë një përleshje mes tij dhe disa personave tani për tani të panjohur në njërin anë dhe të dëmtuarit V.H në anën tjetër, me revolen e tipit të panjohur ka shtënë në drejtim të të dëmtuarve V dhe F.H, i cili ishte kyçur në rrahje, me ç' rast ka shkaktuar rrezik për jetën e tyre,-
 - me çka, kishte për të kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375, par. 2, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, **pasi që prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza.**
- S e p s e:** i akuzuari B.Q, me datë, vend dhe kohë të njëjtë si në dispozitivin nr. 1, të aktakuzës, iu ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor të dëmtuarve V dhe F.H,-

- me çka, kishte për të kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par.1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, **pasi që prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza.**
- 3. S e p s e:** i akuzuari F.H, me datë, vend dhe kohë të njëjtë si në dispozitivin nr. 1, të aktakuzës, i ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor të akuzuarit B.Q, në atë mënyrë pas njoftimit nga ana e vajzës së tij S., se në parkun e qytetit persona të panjohur ishin duke e rrahur vëllain e saj V., i pandehuri ka shkuar në vendin e ngjarjes, me ç' rast në përleshje e sipër e ka goditur me thikë buke të pandehurin B.Q, të cilit i ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor,-
- me çka, kishte për të kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par.1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, **pasi që prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza.**
 - Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.
 - **E dëmtuara S.(F)H**, nga P., rr.M.K, nr., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest. Ndërsa të dëmtuarit F. dhe V.H, nuk janë udhëzuar për kërkesën pasurore juridike pasi kanë heqë dorë nga kjo e drejtë.
 - **Të akuzuarve iu konfiskohen:** karikatorit i revoles së përdorur dhe thika, të gjetura në vendin e ngjarjes, e të cilat janë përdorur për kryerjen e veprës penale.

A R S Y E T I M I

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.I.nr. 690/2013, të datës 29.07.2015, ka akuzuar të pandehurit: B.Q, për shkak të veprave penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375, par. 2, të KPRK dhe Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par. 1, të KPRK dhe F.H, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par.1, të KPRK.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 31.01.2018, në të cilin prokurori i shtetit pas leximit të dispozitivit të aktakuzës, ka deklaruar se meqenëse ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për pikën 2 dhe 3, të dispozitivit të aktakuzës, tërhiqet nga ndjekja penale, kundër të pandehurve F.H dhe B.Q, për veprat penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1, të KPRK, me arsyetim se këto vepra penale janë kryer me datë 31.07.2013, dhe parashkrimi absolut i ndjekjes penale ka arritur me datë 31.07.2017, ndërsa ka shtuar se mbetet pranë aktakuzës për të pandehurin B.Q, për pikën 1 të dispozitivit të aktakuzës përkatësisht për veprën penale nga neni 375, par. 2, të KPRK dhe ka shtuar se sa i përket të pandehurit F.H, i njëjti mbetet në cilësi të dëmtuarit-dëshmitarit.

Pas deklarimit si më lart të Prokurorit të shtetit, seanca e shqyrtimit fillestar ka vazhduar me procedimin e çështjes për të pandehurin B.Q, i cili ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk ka nevojë për sqarime shtesë, e pastaj është deklaruar i pajshëm për veprën penale nga neni 375, par. 2, të KPRK.

Të dëmtuarit F.H dhe V.H, kanë deklaruar se janë pajtuar me të akuzuarin B. dhe nuk ushtrojnë kërkesë për kompensim dëmi.

Pas fjalës hyrëse të palëve, është bërë paraqitja e provave nga prokurori i shtetit, përkatësisht janë dëgjuar dëshmitarët e propozuar.

Gjatë dhënies së dëshmisë së tij, dëshmitari F.H ka deklaruar se ditën kur ka ndodhur ky rast ka qenë në shtëpi, pastaj e kanë thirrë fqinjët dhe ka dalë te parku, ku ka parë shumë njerëz dhe ka dëgjuar fjalët “ B. B “, duke mos e ditur se kush ishte B., i cili ka qenë duke u kacafytur – rrahur me disa persona shtetas të Shqipërisë, e të cilët kishin sulmuar djalin e tani dëshmitarit, të dëmtuarin V.H, i cili kishte qenë duke ardhur nga puna dhe se aty B. ia kishte parë një armë në dorë e të cilën B. e kishte gjuajtur në kontejner. Dëshmitari F. ka theksuar se ka dëgjuar kur ka krisur arma, por kam qenë rreth 30 metra larg dhe nuk ka vërejtur se kush ka shtënë, por kur është afruar, armën ja ka parë në dorë B., për të cilin ka menduar se B. ka gjuajtur me armë, duke shtuar se nuk e di kush ka shtënë me armë, për të cilën ka thënë se ka qenë e vogël dhe ngjyrë e zezë. Pastaj, dëshmitari ka thënë se sipas informatave që ka marrë, ai e di se me armë kanë shtënë personat nga Shqipëria.

Ndërsa, gjatë dhënies së dëshmisë së tij, i dëmtuari - dëshmitari V.H ka deklaruar se i kujtohet ngjarja e datës 31.07.2013, kur ka qenë duke ardhur nga puna, pasi ka hyrë në parkun e qytetit, te “kacallarët”, ka hyrë në konflikt me disa persona nga Shqipëria, me të cilët ka qenë tani i akuzuari B., pastaj ka shtuar se aty janë rrahur me B. dhe me personat nga Shqipëria, duke shtuar se njëri nga personat nga Shqipëria, ka nxjerr revolen dhe ka shtënë 1 deri 2 herë, e pastaj atë revole e ka marrë B.Q dhe e ka gjuajtur në kontejner tek parku i qytetit.

Sa i përket të dëmtuarës S.H, gjatë shqyrtimit gjyqësor Prokurori i shtetit ka heq dorë nga propozimi për dëgjimin e saj në cilësi të dëshmitares.

Po ashtu, është administruar si provë edhe foto-albumi i vendit të ngjarjes, ku vërehet një gëzhgojë, një karikator dhe një thikë.

Gjatë mbrojtjes së tij, i akuzuari ka deklaruar se ditën kur ka ndodhur rasti ka qenë në parkun e qytetit, së bashku me A. G.n dhe personin me nofkën “L”, emrin e të cilit ka thënë se nuk e di, duke shtuar se V. ka pasur problem me disa persona nga Shqipëria, e pastaj kanë filluar të rrahën, e kur në momentin kur familjarët e V. kanë filluar të dalin nga shtëpia me thika në dorë dhe të shumtë në numër, personi me nofkën “L” nga Shqipëria është tërhequr prapa, ka nxjerr nga xhepi një revole të vogël me të cilën ka shtënë dy -tri herë, duke shtuar se kur i ka vërejtur të shtënat me armë, ka shkuar drejt tij – “L”, ia ka marrë nga dora revolen pasi që ishte frikësuar se mos po vritet dikush, ia ka heqë karikatorin dhe revolen e ka gjuajtur në kontejner, pastaj nga aty ka shkuar direkt në stacionin policor “Qendra” në Prishtinë, dhe e ka paraqitur rastin në polici.

Në fjalën e tij përfundimtare, Prokurori i shtetit ka deklaruar se me provat e administruara si më lart në këtë shqyrtim gjyqësor, nuk është vërtetuar se i akuzuari B.Q ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, e paraparë me nenin 375, par. 2, të KPRK, andaj është tërhequr nga ndjekja penale kundër të pandehurit B.Q.

Pasi që, Prokurori i shtetit, është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarve B.Q, i akuzuar për shkak të veprave penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375, par. 2, të KPRK dhe Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par. 1, të KPRK dhe F.H, i akuzuar për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par.1, të KPRK, gjykata në bazë të nenit 363, par. 1, nënpar. 1.1, të KPPK, mori aktgjykim refuzues si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet procedurale u mor në bazë të nenit 454, par. 1, të KPPK.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPK, pala e dëmtuar S.H, është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike. Ndërsa të dëmtuarit F. dhe V.H, nuk janë udhëzuar për kërkesën pasurore juridike pasi kanë heqë dorë nga kjo e drejtë.

Vendimi që të pandehurve t'iu konfiskohen armët, u mor në bazë të nenit 375, par. 3, të KPRK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 363, par. 1, nënpar. 1.1, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 03.05.2018.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.421/15, datë 30.04.2018.

Sekretare juridike,
Arianit Mahmutaj

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari,
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë.